

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal - në përbërje nga gjyqtarit individual Mustaf Tahiri, dhe procesmbajtëse Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të pandehurit V.Sh. nga Ferizaj rr. “.....”, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. i KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1512-2/15 të dt. 09.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të mbajtur më datën 15.08.2016, në praninë e prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të dëmtuarit M.A. si dhe të akuzuarit V.Sh., morri dhe publikisht komunikoi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: V.SH., nga Ferizaj, rr.”.....”, kati III, nr..., data e lindjes ..., nga i ati, A. dhe e ëma H., e gjinisë, Rr., ka të kryer shkollën fillore, me profesion muzikant, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. Personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën 31.08.2012, rreth orës 01:30, ne Ferizaj, në rr.”Bajram dhe Gursel Sylejmani”, përkatësisht në rrugë, pas një mosmarrëveshje lidhur me problemet e mëhershme me të dëmtuarin M.H.A. nga Ferizaj, posa takohen fillon konflikti verbal e më pas konflikti fizik ku i pandehuri me një thikë mjet i rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndime të rënda trupore e godet të dëmtuarin në anën e majtë në bel, duke i shkaktuar lëndim të rëndë trupor të dëmtuarit dhe atë plagë prerëse në anën e majtë të regjionit lumbal (të shpinës), shqyerje në veshkën e majtë me gjakmbledhje në anën e majtë perineale,

me këtë kreu veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 2,4,6,7,8,9,10,17,23, 41,42,43,45,73,74 75,76 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin, e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muajve, i cili dënim do të ekzekutohet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.08.2015 e deri më 29.10.2015.

I dëmtuari, M.(H)A. nga Ferizaj, rr.”.....” në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se heq dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari që të paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 40 €, në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/IL.nr.1512-2/15 të dt.09.11.2015, ka ngarkuar të akuzuarin V.Sh. nga Ferizaj për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 i KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 11.08.2016, në të cilin Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, lexoi aktakuzën ndërsa në fjalën përfundimtare në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri V.Sh., në shqyrtimin gjyqësor fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 i KPRK-së, për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se i vije keq për këtë që ka ndodhur.

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, me rastin e marrjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit V.Sh. të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 i KPRK-së, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranim gjen mbështetje të plotë në të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të cilat edhe është mbështetur aktakuza duke i propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë.

I dëmtuari M.H.A., me rastin e marrjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit V.Sh. të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 i KPRK-së, se se tani me të pandehurin kanë raporte të mira mes vete, se atë natë fillimisht shokët e tij e edhe ai e kishin provokuar, por se nuk kanë pasur qëllim që të përleshën mes vete, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale e as nuk paraqet kërkesën pasurore juridike.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor, gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: dëshmia e dëshmitarëve – të dëmtuarit M.H. e dt.01.10.2015, dëshmia e dëshmitarit E.H. e dt.31.08.2015, deklarimi i vetë të pandehurit i dt.31.08.2015, vërtetimet M.H.A. mbi konfiskimin e sendeve i dt.31.08.2015, raportet mjekësore nga Qendra Emergjente në Ferizaj nr.protokolli 697 të dt.31.08.2015, mendimi dhe konstatimi e ekspertit mjeko ligjor i dt.16.10.2015, si dhe i si dhe fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit V.Sh. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 i KPRK-së, të përshkruar si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ku i akuzuari pas një mosmarrëveshje lidhur me problemet e mëhershme me të dëmtuarin M.H.A. nga Ferizaj, posa takohen fillon konflikti verbal e më pas konflikti fizik ku i pandehuri me një thikë mjet i rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndime të rënda trupore e godet të

dëmtuarin në anën e majtë në bel, duke i shkaktuar lëndim të rëndë trupor të dëmtuarit dhe atë plagë prerëse në anën e majtë të regjionit lumbal (të shpinës), shqyerje në veshkën e majtë me gjakmbledhje në anën e majtë perineale.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, moshën e tij relativisht të re, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, se tani me të dëmtuarin kanë raporte të mira, se është penduar thellë për veprën e kryer penale, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale, se i dëmtuari nuk ju ka bashkangjitur ndjekjes penale, se i pandehuri ka qenë i provokuar nga i dëmtuari, ndërsa si rrethana renduese Gjykata vlerësoj shkallen e përgjegjësisë penale për te pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete te veprës penale, intensitetin dëmit të shkaktuar, edhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata duke i aplikuar dispozitat nga neni 75 dhe 76 të KPRK-së bëri zbutjen e dënimit duke qenë e bindur se me dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale, dhe ky dënim të ndikoj te i pandehuri që ai të përmbahet nga përsëritja e veprave penale, po ashtu të arrihet edhe qëllimi ndëshkimorë në kuptim të preventives gjenerale, që dënimi i shqiptuar të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të natyrës së njejtë apo të ngjajshme.

I dëmtuari, M.(H)A. nga Ferizaj, rr.”.....” në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se hek dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari që të paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësorë për ekspertizën mejko ligjore te paguaj shumën prej 20€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor ne shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.1409/15, dt.15.08.2016

Sekretarja Juridike ,

Albana Ajvazi

Gjyqtari,

Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.